

Ndër gjetjet kryesore të këtij raporti janë:

- Qasja në informata në lidhje me lëndët në gjykata themelore është ende sfidë për 54% të avokatëve të anketuar, për të cilët marrja e informacionit të nevojshëm vazhdon të jetë e vështirë;
- Për avokatët, burimet më të zakonshme të informacionit rreth lëndëve janë administrata e gjykatës dhe gjyqtarët (48% e përgjigjeve);
- 60% e avokatëve të anketuar nuk flasin me gjyqtarët për lëndët e tyre;
- Ueb-faqet e gjykatave nuk janë burim parësor i informacionit për avokatët - 62% e të anketuarve nuk i përdorin ato, ndërsa shumë prej tyre nuk kishin pasur mundësi ta gjenin informacionin që kishin kërkuar;
- 45% e avokatëve nuk ishin të vetëdijshëm për ekzistencën e kutive të ankesave në gjykata apo deklaruan se këto kuti nuk ishin vendosur asnjëherë (17%);
- Pothuajse 70% e të anketuarve nuk kanë vërejtur përmirësime në qasjen në informata krahasuar me vitin paraprak;
- 41% e të anketuarve besojnë se transparenca ishte përmirësuar në gjykatat themelore;
- Vetëm 19% e avokatëve pohuan se gjykatat themelore janë bërë më efikase në trajtimin e lëndëve dhe kjo falë automatizmit, etj.